



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.82

4 gusht

2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr.53, datë 24.7.2006	Për miratimin e Raportit Përfundimtar, konkluzioneve dhe rekomandimeve të Komisionit Hetimor të Kuvendit, ngritur me vendimin nr.31, datë 2.5.1006.....	2801
Vendim i Kuvendit nr.54, datë 28.7.2006	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	2801
Vendim i Kuvendit nr.55, datë 28.7.2006	Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.....	2802
Vendim i Kuvendit nr.56, datë 28.7.2006	Për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.....	2802
Vendim i Kuvendit nr.57, datë 28.7.2005	Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues të RTSH-së....	2803
Dekret nr.4999 datë 27.7.2006	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	2803
Dekret nr.5000 datë 27.7.2006	Për emërim ambasadori.....	2804
Dekret nr.5002 datë 31.7.2006	Për emërim të anëtarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve....	2805

Vendim i KM nr.511, datë 5.7.2006	Për lejimin e komandës së mbështetjes logjistike, Tiranë, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, për prodhimin e veshjeve ushtarake, të artikujve për fjetje dhe atyre të saraçerisë, për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes.....	2805
Vendim i KM nr.512, datë 31.5.2006	Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore....	2807
Urdhër i MF	Për disa ndryshime në urdhrin nr.2, datë 3.12.2004 të Ministrit të Financave “Për sekuestrimin e aseteve të shtetasit arab Yasin Al-Qadi, i njohur dhe si: a) Shaykh Yassin Abdullah Kadi, b) Yasin Kahdi, c) Yassin Kadi, ç) Kadi Jassin, d) Yassin Abdullah Kadi”.....	2809
Urdhër i MF	Për disa ndryshime në urdhrin nr.5, datë 10.03.2005 të Ministrit të Financave “Për sekuestrimin e pasurive të shtetasit Nabil Abdyl Sayadi, i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit”.....	2810
Urdhër i MF	Për disa ndryshime në urdhrin nr.6, datë 10.03.2005 të Ministrit të Financave “Për sekuestrimin e pasurive të shtetasës Patricia Rosa Vinck, e cila rezulton e shpallur në listën e financuesve të terrorizmit”.....	2811
Urdhër i MF	Për disa ndryshime në urdhrin nr.7, datë 10.03.2005 të Ministrit të Financave “Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit “Global Relief Foundation”, GRF, i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit”.....	2811
Urdhër i MF	Për disa ndryshime në urdhrin nr.8, datë 10.03.2005 të Ministrit të Financave “Për sekuestrimin e pasurive të fondacionit “Ringjallja e trashëgimisë islame”, e njohur dhe si “Revival of Islamic Heritage Society”, RIHS, i cili rezulton i shpallur në listën e financuesve të terrorizmit”.....	2812
Vendim i GJK nr.21, datë 24.7.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.207, datë 8.12.2000 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.532, datë 6.7.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.....	2813
Vendim i GJK nr.22, datë 26.7.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.736, datë 28.4.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën.....	2815
	Shpallje kërkesë për shpronësim me interes publik të pasurisë së paluajtshme, pronë private, të tipit “Tokë bujqësore arë”, që preket nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV, Elbasan.....	2818
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Dashamir Muçllari.....	2820

VENDIM
Nr. 53, datë 24.7.2006

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR, KONKLUZIONEVE DHE
REKOMANDIMEVE TË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT, NGRITUR
ME VENDIMIN NR.31, DATË 2.5.2006**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 20, 21 e 22 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të nenit 114 pika 3 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet Raporti Përfundimtar, konkluzionet dhe rekomandimet e Komisionit Hetimor të Kuvendit, ngritur me vendimin nr.31, datë 2.5.2006 “Për ngritjen, caktimin e objektit, të përbërjes dhe të afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 54, datë 28.7.2006

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 154 pika 1 të Kushtetutës, të nenit 22 pika 1 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Arben Ristani zgjidhet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 55, datë 28.7.2006

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVIZIONIT**

Në bazë të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës dhe në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zgjidhen në detyrën e anëtarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT):
1. Mesila Doda
 2. Frano Kulli
 3. Alban Karapici
 4. Ledi Bianku
 5. Detar Hysi
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 56, datë 28.7.2006

**PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE
TELEVIZIONIT**

Në bazë të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës dhe në mbështetje të pikës 5 të nenit 9 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zoti Ledi Bianku zgjidhet në detyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT).
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 57, datë 28.7.2006

PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH-SË

Në bazë të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës dhe në mbështetje të nenit 88 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zgjidhen në detyrën e anëtarit të Këshillit Drejtues të RTSH-së:

1. Fatos Lubonja
 2. Agron Tufa
 3. Marjan Braka
 4. Fatmir Braka
 5. Besnik Dizdari
 6. Artan Minarolli
 7. Gjergj Xhuvani
- II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

DEKRET
Nr. 4999, datë 27.7.2006

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|-------------------------------------|-----------------------------------|
| 1. Edevaldo Muharrem Hodo | 29. Alketa Enver Peza (Duka) |
| 2. Arjel Kristaq Toçi | 30. Margarita Lazar Tegu |
| 3. Emanuela Tonin Luka | 31. Hermann Vasil Budo |
| 4. Elza Dhimitër Çani (Cani) | 32. Klodjan Vasil Budo |
| 5. Eljana Xhevdet Sulo | 33. Vera Kadri Dosti (Aga) |
| 6. Vjollca Tetem Manaj (Lutaj) | 34. Rea Besnik Koxha |
| 7. Jens Gëzim Manaj | 35. Violeta Josif Schulze (Zhama) |
| 8. Mariola Gëzim Manaj | 36. Enver Ismet Smira |
| 9. Juna Gëzim Manaj | 37. Arben Baftjar Tahiri |
| 10. Rudina Tajar Schreier (Hysenaj) | 38. Maksim Nuredin Skënderaj |

- | | |
|--------------------------------------|--|
| 11. Shpetim Hatip Tota | 39. Saimir Mas'har Kunxholli |
| 12. Silvana Ali Kala-Schülpen (Kala) | 40. Franc Saimir Kunxholli |
| 13. Almir Rustem Spahiu | 41. Nadja Saimir Kunxholli |
| 14. Manuel Almir Spahiu | 42. Tomas Saimir Kunxholli |
| 15. Fabian Almir Spahiu | 43. Majlinda Shaban Kunxholli (Canameri) |
| 16. Besa Kasem Spahiu (Pali) | 44. Eduard Sabri Lluka |
| 17. Rexhina Aliko Palumbo (Duka) | 45. Alvi Pal Delia |
| 18. Viktor Nikollë Mrinaj | 46. Dorentina Pal Delia |
| 19. Luis Viktor Mrinaj | 47. Klotilda Et'hëm Aliaj |
| 20. Julio Viktor Mrinaj | 48. Kevin Björn Aliaj |
| 21. Ardiana Simon Mrinaj (Vathkruja) | 49. Lirika Jakup Kasneci (Dabulla) |
| 22. Maria Petro Konomi (Strakosha) | 50. Doriana Alqi Kasneci |
| 23. Artur Aveni Halili | 51. Gjergji Alqi Kasneci |
| 24. Gersi Artur Halili | 52. Adnan Jusuf Kastrati |
| 25. Thomas Artur Halili | 53. Suzana Salih Kastrati (Angoni) |
| 26. Mimoza Ajet Halili (Fida) | 54. Lisian Adnan Kastrati |
| 27. Mustafa Halim Peza | 55. Bledi Astrit Halili |
| 28. Fabian Mustafa Peza | |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 5000, datë 27.7.2006

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika dh, dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Bujar Skëndo, Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Bullgarisë, rezident, emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Moldavisë, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

DEKRET
Nr. 5002, datë 31.7.2006

PËR EMËRIM TË ANËTARIT TË KOMSIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në bazë të neneve 154, pika 1 dhe 93 të Kushtetutës, dhe të nenit 22 pika 2 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Fatmir Kumbaro emërohet anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr. 511, datë 5.7.2006

**PËR LEJIMIN E KOMANDËS SË MBËSHTETJES LOGJISTIKE, TIRANË, TË PËRDORË
PROCEDURËN “PROKURIMI I DREJTPËRDREJTË”, PËR PRODHIMIN E VESHJEVE
USHTARAKE, TË ARTIKUJVE PËR FJETJE DHE ATYRE TË SARAÇERISË, PËR
NEVOJA TË MINISTRISË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e komandës së mbështetjes logjistike, Tiranë që, për fondin limit prej 94 878 700 (nëntëdhjetë e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind) lekësh , të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë“, me Ndërmarrjen e Prodhimit të Veshjeve të Ushtrisë Tiranë, për nevojat e Ministrisë së Mbrojtjes, për prodhimin e:

a) veshjeve ushtarake dhe të artikujve për fjetje, me lëndë të parë të porositësit (komanda e mbështetjes logjistike, Tiranë), sipas pasqyrës “A”, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) artikujve të saraçerisë për mirëmbajtjen e armatimit, sipas pasqyrës “B”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare , që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2006, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ndërmarrja e Prodhimit të Veshjeve të Ushtrisë, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PASQYRA (A)
FONDET PËR KONFEKSIONIMIN E VESHJEVE ME NPVU ME MATERIAL
TË POROSITËSIT

Mijë lekë

Nr.	Emërtimi i materialit	Nj/matjes	Nevojat	Çmimi për njësi	Fondi limit
1	Kostum pune teritali	komp.	1600	5905	9448
2	Kostum ceremonial	komp.	300	4953	1485.9
3	Kost.kamufl. +kaki b.SHP	komp.	14800	2275	33670
4	Xhupa kamuflazhi	copë	7500	2918	21885
5	Xhaketon leshi FD	copë	600	2203	1321.8
6	Kostum operacinal shërbimi (PU)	komp.	250	2275	568.75
7	Kostum doku i zi b.spec	komp.	120	2275	273
8	Kostum doku marine	komp.	400	2123	849.2
9	Kostum teritali 1-d detari	komp.	400	2014	805.6
10	Bereta teritali marine	copë	400	599	239.6
11	Bluza 1-d verore detari	copë	400	1513	605.2
12	Xhakoventa of.	copë	2000	2003	4006
13	Këmisha me mëngë të gjata	copë	6000	608	3648
14	Këmisha me mëngë të shkurtëra	copë	8000	559	4472
15	Mushama shiu	copë	1000	2038	2038
16	Kapele mod zarf	copë	2000	810	1620
17	Pelerin shiu	copë	1200	2038	2445.6
18	Çarçaf kambriku	copë	8000	71	568
19	Këllëf jastëku	copë	4000	37	148
20	Kostume civile	komp.	300	9270	2781
	Shuma	lekë			92878.7

PASQYRA (B)
FONDET PËR MATERIALET PËR MIRËMBAJTJEN E ARMATIMIT

Nr.	Emërtimi materialit	Sasia	Lekë për copë	Vlefte lekë
1	Prodhim rripa për automatikë 7.62 mm Mod.56	1594	240	382560
2	Prodhim gjoksore për automatikë 7.62 mm Model 56	1000	488.4	488400
3	Prodhim mbulesa komplet për obuz 122 mm	16	15988	255808
4	Prodhim mbulesa komplet për Top 37 mm KA 2 gr.zj.	8	13651	109208
5	Prodhim mbulesa komplet për top 75 mm PS	8	6000	48000
6	Prodhim mbulesa komplet për Top-Obuz 152 mm	18	19891	358038
7	Prodhim mbulesa komplet për Top 122 mm	18	19891	358038
	Shuma			2 000 000

VENDIM
Nr. 512, datë 31.5.2006

**PËR PROCEDURAT E KRYERJES SË KONTROLLIT TË NDIHMËS EKONOMIKE, TË
PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 27 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I

**ORGANIZIMI, OBJEKTI DHE RAPORTI I KONTROLLIT TË NDIHMËS EKONOMIKE,
PAGESËS SË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE**

1. Kontrolli i ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore, organizohet dhe kryhet nga Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, në bazë të procedurave të përcaktuara në këtë vendim.

2. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore është i organizuar dhe funksionon në nivel qendror dhe rajonal.

3. Kontrolli bazohet në planin vjetor dhe në programin mujor të punës. Programi i kontrollit përgatitet nga grupi i kontrollit dhe miratohet nga titullari i institucionit.

4. Programi i kontrollit duhet të përmbajë:

- a) Subjektet, që do të kontrollohen;
- b) Llojin e kontrollit, që do të ushtrohet;
- c) Periudhën, për të cilën do të bëhet kontrolli;
- c) Objektivat, që duhet të realizohen.

5. Kontrolli programohet për çdo muaj dhe mund të jetë i plotë ose tematik. Në çdo rast, përpara kryerjes së kontrollit, drejtuesi i grupit të kontrollit njofton me shkrim subjektin për fillimin e kontrollit, qëllimin, si dhe objektivat që do të realizohen.

6. Kontrolli mund të jetë i paparalajmëruar, në rastet kur ka sinjalizime për abuzime ose shkelje ligjore nga subjekti përkatës.

7. Sinjalizime konsiderohen:

- a) Ankesat me shkrim të klientëve, që përfitojnë shërbimet e subjektit përkatës;
- b) Njoftime me shkrim ose me mjete të tjera komunikimi të personave të interesuar për veprimtarinë e subjektit, pasi ky veprim të jetë vlerësuar si joabuziv;
- c) Njoftime ose ankime, të çdo forme, nga entet publike.

8. Raporti përfundimtar i kontrollit bëhet nga grupi i kontrollit, i cili vlerëson ose jo komentet e subjektit të kontrolluar. Në përfundim të kontrollit, një kopje e raportit i dorëzohet subjektit të kontrolluar. Nëse nga raporti përfundimtar i kontrollit, vihen në dukje shkelje të legjislacionit, Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, propozon njërën nga masat e mëposhtme:

- a) pezullimin e veprimtarisë së subjektit deri në plotësimin e standardeve përkatëse;
- b) Mosrinovimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë;
- c) Heqjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë dhe mbylljen e saj;
- ç) Fillimin e procedurave për shlyerjen e dëmit të shkaktuar, në zbatim të legjislacionit civil dhe legjislacionit të veçantë;
- d) Masën disiplinore, për personat përgjegjës në subjektet publike, të cilët kanë shkaktuar dëmin apo kanë shkelur dispozitat ligjore dhe nënligjore, në fuqi, nëse veprimtaria e subjektit bie ndesh me Kodin e Procedurave Administrative;

dh) Fillimin e procedurave nga autoriteti përgjegjës, kur mendohet se janë konsumuar elemente të veprës penale.

9. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, pas heqjes së licencës kërkon pranë gjykatës shpërndarjen e shoqatës ose fondacionit, sipas parashikimeve të kreut II të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

10. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore për subjektet juridike, shoqëritë tregtare, njofton organet tatimore për heqjen e licencës së subjektit përkatës.

KREU II

PROCEDURAT E KONTROLLIT TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE PAGESËS SË AFTËSISË SË KUFIZUAR

1. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore kontrollon:

a) veprimtarinë e seksionit ose të zyrës së ndihmës ekonomike, pagesës së aftësisë së kufizuar, përkatësisht, në bashki/komunë;

b) zbatimin e legjislacionit përkatës për ndihmën ekonomike dhe pagesën e aftësisë së kufizuar;

c) vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga pretenduesit për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar;

ç) verifikimin e kryer nga administratorët, kur gjykohet e nevojshme, si dhe bën intervistim ose vizitë në familje, të përfituesve të ndihmës ekonomike;

d) verifikimin/intervistimin e personave me aftësi të kufizuar, ballafaqimi e tyre me vendimin e komisionit;

dh) përputhjen ndërmjet listëpagesave dhe thesarit, numrit të familjeve përfituese dhe shumave të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe pagesës për aftësinë e kufizuar;

e) saktësinë e të dhënave në planifikimin e nevojave për fonde;

ë) mënyrën e planifikimit të fondit të ndihmës ekonomike dhe të fondeve për pagesën e aftësisë së kufizuar;

f) numrin dhe shpërndarjen e fondeve të ndihmës ekonomike, pagesës për aftësinë e kufizuar nga këshilli i bashkisë/komunës.

2. Inspektorët e këtij inspektorati pas çdo kontrolli hartojnë aktkontrollin për njësinë e kontrolluar.

3. Për të gjitha rastet e shkeljeve ligjore të vërejtura, grupi i kontrollit njofton me shkrim prefektin.

4. Grupi i kontrollit paraqet në administratën e kryetarit të bashkisë/komunës materialin përmbledhës të rezultatit të kontrollit, ku evidentohen të gjitha shkeljet e vëna re nga administrata e qeverisjes vendore apo këshilli i pushtetit vendor, që lidhet me zbatimin e legjislacionit për dhënie e ndihmës ekonomike dhe pagesës për aftësinë e kufizuar, si dhe propozimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes dhe për masat për personat përgjegjës, të cilat janë:

a) gjobë, sipas neneve 5 dhe 6 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative;

b) vërejtje me shkrim;

c) propozim për largim nga puna;

ç) propozim për fillimin e procedurave nga autoriteti kompetent, në rastet kur mendohet se janë konsumuar elementet e veprës penale ose të kundërvajtjes penale.

5. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, që vepron në nivel qendror, kontrollon, çdo vit, veprimtarinë e inspektorateve, që veprojnë në nivel rajonal dhe, duke zbatuar metodën me zgjedhje, kontrollon edhe veprimtarinë e njësisve të qeverisjes vendore.

6. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore në nivel rajonal kontrollon të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me programin e kontrollit, të përcaktuar në pikën 4 të kreut I të këtij vendimi.

7. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, në nivel qendror dhe rajonal, kontrollojnë programin e fondeve e mënyrën dhe përdorimit të tyre, respektimin e destinacionit të fondeve, të ndihmës ekonomike dhe pagesës për aftësinë e kufizuar dhe, për shkeljet e vëna re, mund të propozojë ndërprerjen e fondeve.

KREU III

PROCEDURAT E KONTROLLIT TË SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SHOQËRORE

1. Programi i kontrollit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, që ofrohet nga subjektet përkatëse, në sektorin, publik dhe privat, të jetë sipas pikës 4 të kreut I të këtij vendimi.

2. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore kontrollon:

- a) plotësimin e standardeve të shërbimit, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) zbatimin e legjislacionit në fuqi, sipas natyrës së shërbimeve që kryhen;
- c) dokumentacionin e çdo personi, që përfiton shërbime;
- ç) kushtet higjieno-sanitare të institucionit;
- d) dokumentacionin e nevojshëm të personelit, që ofron shërbimin.

3. Në institucionet e shërbimeve rezidenciale, në përputhje me specifikën e këtyre shërbimeve, mund të bëhen kontrole edhe natën.

4. Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore kontrollon veprimtarinë e të gjitha subjekteve, që ofrojnë shërbime të përkujdesjes shoqërore, të paktën dy herë në vit. Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara bëhet në bazë të plotësimit të standardeve, të veçanta dhe të përgjithshme, të parashikuara nga legjislacioni përkatës.

5. Ky inspektorat, për shkeljet e vëna re ose për moszbatimin e standardeve të shërbimeve të ofruara, cakton detyra dhe afate për përmirësimin e situatës.

6. Grupi i kontrollit harton projektraportin për kontrollin e kryer dhe një kopje ia dorëzon subjektit të kontrolluar, i cili, brenda një afati 10 ditë-pune, paraqet vërejtjet apo kundërshtitë e veta për këtë projektraport. Gjatë kësaj faze realizohet një takim, ku diskutohet me palën e kontrolluar.

7. Për të gjitha shkeljet e vëna re, Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore njofton Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe paraqet në administratën e prefektit raportin përmbledhës të rezultateve të kontrollit të kryer.

8. Subjekti i kontrolluar nga Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Persona me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore, ka të drejtë të ankohet sipas dispozitave ligjore, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

9. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Brendshme për nxjerrjen e udhëzimit në zbatim të këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHURIN NR.2, DATË 3.12.2004 TË MINISTRIT TË FINANCAVE “PËR SEKUESTRIMIN E ASETETEVE TË SHTETASIT ARAB YASIN AL-QADI I NJOHUR DHE SI: A) SHAYKH YASSIN ABDULLAH KADI, B) YASIN KAHDI, C) YASSIN KADI, Ç) KADI JASSIN, D) YASSIN ABDULLAH KADI”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.2, datë 3.12.2004 bëhen ndryshimet si më poshtë vijnë:

3. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

“Brenda 3 ditëve, të njoftohen me shkrim për llogaritë bankare, pasuritë, investimet, shoqëritë tregtare a personat juridikë, aktivitetet e tjera, si dhe vendndodhjen e tyre, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave”.

1. Në fjalinë e parë të pikës 13 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Shprehja “për transaksionet”, zëvendësohet nga shprehja “për evidentimin e pasurive, shoqërive tregtare a personave juridikë sipas pikave të këtij urdhri dhe transaksioneve”.

2. Fjalja e dytë e pikës 13 ndryshon si më poshtë:

“RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave brenda 72 orëve nga momenti i konstatimit të transaksioneve ose ekzistencës së këtyre pasurive, shoqërive tregtare a personave juridikë, të përcaktuar në pikat e këtij urdhri”.

4. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhëri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.07.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr. 8610, datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

5. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHURIN NR.5, DATË 10.03.2005 TË MINISTRIT TË FINANCAVE “PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË SHTETASIT NABIL ABDYL SAYADI, I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258 datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.5 datë 10.03.2005 bëhen ndryshimet si më poshtë vijnë:

1. Në fjalinë e parë të pikës 9 bëhet ndryshimi si më poshtë:
Shprehja “për transaksionet”, zëvendësohet nga shprehja “për evidentimin e pasurive, shoqërive tregtare a personave juridikë sipas pikave të mësipërme të këtij urdhri dhe transaksioneve”.

2. Fjalja e dytë e pikës 9 ndryshon si më poshtë:
“RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave brenda 72 orëve nga momenti i konstatimit të transaksioneve ose ekzistencës së këtyre pasurive, shoqërive tregtare a personave juridikë të përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij urdhri”.

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:
“Brenda 3 ditëve, të njoftohen me shkrim për llogaritë bankare, pasuritë, investimet, shoqëritë tregtare a personat juridikë të tjerë, aktivitetet e tjera, si dhe vendndodhjen e tyre, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave”.

4. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhëri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.07.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

5. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 6, DATË 10.03.2005 TË MINISTRIT TË FINANCAVE “PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË SHTETASES PATRICIA ROSA VINCK, E CILA REZULTON E SHPALLUR NË LISTËN E FINANCAVES TË TERRORIZMIT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 6, datë 10.03.2005 bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Në fjalinë e parë të pikës 9 bëhet ndryshimi si më poshtë:
Shprehja “për transaksionet”, zëvendësohet nga shprehja “për evidentimin e pasurive, shoqërive tregtare a personave juridikë sipas pikave të mësipërme të këtij urdhri dhe transaksioneve”.

2. Fjalja e dytë e pikës 9 ndryshon si më poshtë:
“RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave brenda 72 orëve nga momenti i konstatimit i transaksioneve ose ekzistencës së këtyre pasurive, shoqërive tregtare a personave juridikë të përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij urdhri”.

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“Brenda 3 ditëve, të njoftohen me shkrim për llogaritë bankare, pasuritë, investimet, shoqëritë tregtare a personat juridikë të tjerë, aktivitetet e tjera si dhe vendndodhjen e tyre, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave”.

4. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.07.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

5. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 7, DATË 10.03.2005 TË MINISTRIT TË FINANCAVE “PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT “GLOBAL RELIEF FOUNDATION”, GRF, I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.7, datë 10.03.2005 bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1 Në fjalinë e parë të pikës 9 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Shprehja “për transaksionet”, zëvendësohet nga shprehja “për evidentimin e pasurive sipas pikave të mësipërme të këtij urdhri dhe transaksioneve”.

2. Fjalja e dytë e pikës 9 ndryshon si më poshtë:

“RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave brenda 72 orëve nga momenti i konstatimit të transaksioneve ose ekzistencës së këtyre pasurive të përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij urdhri”.

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“Brenda 3 ditëve, të njoftohen me shkrim për llogaritë bankare, pasuritë, investimet, aktivitetet e tjera si dhe vendndodhjen e tyre, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave”.

4. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr. 9258, datë 15.07.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

5. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHURIN NR.8, DATË 10.03.2005 TË MINISTRIT TË FINANCAVE “PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT “RINGJALLJA E TRASHËGIMISË ISLAME”, E NJOHUR DHE SI “REVIVAL OF ISLAMIC HERITAGE SOCIETY” RIHS, I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN Ë FINANCVESVE TË TERRORIZMIT”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, ligjit nr.9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.8, datë 10.03.2005 bëhen ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Në fjalinë e parë të pikës 9 bëhet ndryshimi si më poshtë:

Shprehja “për transaksionet”, zëvendësohet nga shprehja “për evidentimin e pasurive sipas pikave të mësipërme të këtij urdhri dhe transaksioneve”.

2. Fjalja e dytë e pikës 9 ndryshon si më poshtë:

“RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave brenda 72 orëve nga momenti i konstatimit të transaksioneve ose ekzistencës së këtyre pasurive të përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij urdhri”.

3. Pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“Brenda 3 ditëve, të njoftohen me shkrim për llogaritë bankare, pasuritë, investimet, aktivitetet e tjera si dhe vendndodhjen e tyre, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave”.

4. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.07.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

5. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr. 21, datë 24.7.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Piloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 17.2.2006 dhe 9.3.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.12 Akti që i përket:

KËRKUES: ALFIO TETA (ALTIN HALILI), përfaqësuar nga avokati Agim Gogu, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.207, datë 8.12.2000 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe nr.532, datë 06.07.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve të lartpërmendura:

- Në mungesë të tij, familjarët nuk janë vënë në dijeni lidhur me akuzën penale, me veprimet procedurale të kryera gjatë hetimeve paraprake dhe vendimet gjyqësore përkatëse;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë nuk i ka komunikuar ankimin e paraqitur nga prokurori, kundër vendimit të pafajësisë.
- Gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Vlorë, nuk i është mundësuar mbrojtje efektive nga avokati i caktuar kryesisht.
- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke shqyrtuar vendimin gjyqësor me anën e të cilit kërkuesi është rivendosur në afat, ka dalë tej objektit të rekursit që i ishte paraqitur për shqyrtim.
- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka mbajtur parasysh faktin se në gjykimin e çështjes për rivendosjen në afat, kërkuesi ka qenë i pranishëm dhe ka dhënë shpjegimet përkatëse.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vjollca Meçaj, përfaqësuesin e kërkuesit dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Me vendimin nr.79, datë 3.7.2000 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, pasi shqyrtoi çështjen në mungesë të të pandehurit Alfio Teta (Altin Halili), e ka deklaruar të pafajshëm për veprën penale të vrasjes me dashje, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, kurse për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal, e ka deklaruar fajtor dhe e ka dënuar me 2 (dy) vjet burgim.

Prokurori ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila, me vendimin nr.207, datë 8.12.2000, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe, duke e gjykuar çështjen, në fakt e ka deklaruar të pandehurin fajtor për veprën penale të vrasjes me dashje dhe e ka dënuar me 12 vjet burgim. Kjo gjykatë ka lënë në fuqi vendimin për akuzën e armëmbajtjes pa leje dhe në bashkim të dënimeve, e ka dënuar të pandehurin përfundimisht me 12 vjet burgim. Ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar rekurs.

Në datën 13.9.2004, në mjediset e Aeroportit të Rinasit, forcat e policisë kanë ndaluar kërkuesin ndërsa kthehej në Shqipëri, i kanë komunikuar vendimin penal të formës së prerë dhe e kanë shoqëruar për të filluar vuajtjen e dënimit. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për ta rivendosur në afat, me qëllim ushtrimin e rekursit ndaj vendimit të dënimit. Gjykata e ka pranuar kërkesën. Mbi këtë bazë kërkuesi ka paraqitur rekurs përpara Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i cili me vendimin nr.532, datë 06.07.2005 ka vendosur mospranimin e rekursit.

Gjykata Kushtetuese çmon se për të gjykuar rreth kushtetutshmërisë së vendimit të sipërcituar, është me rëndësi të trajtohet, së pari, problemi i kufijve të shqyrtimit gjyqësor në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë. Kjo çështje gjen rregullimin e saj në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 434 i këtij Kodi, duke respektuar natyrën dhe funksionin e Gjykatës së Lartë, ka sanksionuar se kjo gjykatë shqyrton çështjen penale që është ankimuar brenda kufijve të shkaqeve të ngritura në rekurs, megjithatë ruan të drejtën për të vënë në diskutim edhe çështje të tjera ligjore, që duhet të shiheshin kryesisht nga gjykata në çdo gjendje e shkallë të procedimit, e që nuk janë parë. Gjykata Kushtetuese vlerëson se objekt i shqyrtimit mbetet gjithmonë çështja gjyqësore ndaj të cilës është ushtruar rekurs. Kjo lidhet me efektivitetin e të drejtës së ankimit.

Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se në dhomën e këshillimit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin për gjykim të çështjes penale, ndaj të cilës kërkuesi kishte ushtruar rekurs. Mbi këtë bazë, në datë 6.7.2005, në prani të mbrojtësit të të pandehurit dhe të prokurorit është zhvilluar gjykimi në seancë plenare. Përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor të rekursit, prokurori ka parashtruar një kërkesë paraprake, që lidhet me ligjshmërinë e vendimit që kishte rivendosur në afat të drejtën e të pandehurit për ushtrimin e rekursit. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pas kësaj kërkesë ka përfunduar shqyrtimin e çështjes dhe ka vendosur mospranimin e rekursit. Në këtë gjykim nuk rezulton të jetë marrë në shqyrtim rekursi i parashtruar nga kërkuesi.

Në këto rrethana, Gjykata Kushtetuese çmon se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i papajtueshëm me Kushtetutën, sepse është rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, pasi kërkuesit i është shkelur e drejta e aksesit në gjykatë. Kjo e drejtë, si një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, është e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke pranuar kërkesën paraprake të prokurorit, ka përfshirë në shqyrtim materialet e çështjes gjyqësore të rivendosjes në afat të të pandehurit, ndonëse ato i përkisnin një çështjeje tjetër gjyqësore, shqyrtimi i së cilës kishte përfunduar dhe vendimi përkatës kishte marrë formë të prerë, sepse prokurori nuk ushtroi ndaj tij rekurs, siç përcaktohet në nenin 147 paragrafi 5 i Kodit të Procedurës Penale. Kjo dispozitë procedurale është specifike, sepse ndryshe nga rregulli i përgjithshëm për ankimimin e vendimeve, parashikon shprehimisht: “Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar”. Në këto rrethana, prokurori, nëse nuk ishte dakord me vendimin e rivendosjes në afat të të pandehurit, duhej ta ankimonte atë përpara se të merrej në shqyrtim rekursi i kërkuesit ndaj vendimit përfundimtar. Ai nuk mund të ezauronte ankimin e tij nëpërmjet kërkesës paraprake.

Sa më sipër është pranuar edhe nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin e tyre unifikues nr.2, datë 14.10.2002.

Përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimues, në formë e në përmbajtje, siç është sanksionuar në nenet 407/3, 412 dhe 414 të Kodit të Procedurës Penale, nuk përbën një kërkesë ligjore formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e të drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim.

Nëpërmjet mjetit procedural të ankimit apo rekursit, subjektet pjesëmarrës, në gjykimin penal marrin dijeni rreth pretendimeve reciproke, që i janë parashtruar gjykatës për shqyrtim dhe në këtë mënyrë, atyre iu mundësohet pjesëmarrja aktive në shqyrtimin gjyqësor të çështjes, në kushte të barabarta. Lidhur me këtë aspekt të rregullsisë së procesit gjyqësor, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut thekson: “Kushdo duhet të ketë mundësinë t’i paraqesë gjykatës, në mënyrën e duhur, çështjen e vet, në kushte që nuk e vendosin atë në situatë dukshëm të pafavorshme në raport me palën kundërshtarë”¹.

Së fundi, Gjykata Kushtetuese çmon se në rrethanat kur kërkuesi është gjykuar e dënuar në mungesë, pa u vënë në dijeni personalisht në lidhje me akuzat dhe procesin në ngarkim të tij, i duhet garantuar e drejta për të pasur një gjykim në përputhje me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga sa u parashtrua më lart, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhet shfuqizuar si i papajtueshëm me Kushtetutën.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 132 të Kushtetutës, si dhe nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.532, datë 06.07.2005 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

Nr. 22, datë 26.7.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datë 21.02.2006, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.14 Akti që i përket:

¹ Vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut “Dombo Beheer B.V. kundër Holandës” i datës 27.10.1993.

KËRKUES: DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE, DEGA VLORË, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit, Petrit Myftari, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: SHPK "STEFA" ME ORTAK TË VETËM PANAJOT STEFËN, përfaqësuar nga avokat Agim Gogu, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.736, datë 28.04.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e vendimit të mësipërm:

- Rekursi është depozituar brenda afatit ligjor të ankimit dhe Gjykata e Lartë duke mos pranuar shqyrtimin ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor.

- Dorëzimi i rekursit brenda afatit 30-ditor vërtetohet me faktin që data 28 shkurt 2004 është ditë e shtunë (ditë pushimi) dhe si rrjedhojë dorëzimi nuk mund të bëhet në këtë ditë.

- Vetë Gjykata e Lartë pranon që rekursi është depozituar në gjykatë dhe se ai nuk është regjistruar në librin e pranimit të rekursit.

- Përgjegjësia dhe pasojat e mosregjistrimit në gjykatë nuk duhet të rëndojnë mbi palën që ankohet.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesin e kërkuesit që kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.1609, datë 08.10.2003, ka rrëzuar padinë e Subjektit të interesuar, SHPK "Stefa", ngritur kundër kërkuesit, degës së doganës Vlorë, për pavlefshmërinë e dy titujve ekzekutivë, përkatësisht në shumat 68.480.224 lekë dhe 14.517.131 lekë.

Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.9, datë 28.01.2004, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe i ka konstatuar të pavlefshëm titujt ekzekutivë për borxhin doganor të subjektit të interesuar në shumat e lartpërmendura.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka paraqitur rekurs kërkuesi dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.736, datë 28.04.2005, ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë me arsyetimin se rekursi, meqenëse është dorëzuar jashtë afatit, duhet konsideruar se ai mungon.

Gjykata Kushtetuese shqyrtoi paraprakisht pretendimin e subjektit të interesuar, sipas të cilit kërkuesi, duke qenë person juridik publik, nuk mund të pretendojë se mbron të drejta themelore, në kuptim të neneve 16, 131/f e 134 të Kushtetutës dhe si rrjedhojë nuk legjitimohet të verë në lëvizje këtë Gjykatë.

Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se në rastin në shqyrtim kërkuesi, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, legjitimohet të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sepse ky legjitimim nuk kushtëzohet nga karakteri i personit juridik (publik apo privat), por nga natyra e pretendimeve që ai parashtron. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është person juridik publik, që ka pretenduar shkeljen e të drejtave procedurale që rrjedhin nga Kushtetuta. Në këtë drejtim duhet bërë dallimi midis legjitimitimit të personave juridikë publikë që pretendojnë cenime të të drejtave themelore substanciale nga legjitimimi i subjekteve të së drejtës publike që pretendojnë cenime të të drejtave themelore procedurale. Shteti ose organet përbërëse të tij, me disa përjashtime, nuk mund të konsiderohen subjekte përfituese, të të drejtave e lirive themelore substanciale dhe si rrjedhojë nuk legjitimohen për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Në çështjen në shqyrtim kërkuesi është person juridik publik, i paditur në gjykim, dhe pretendon cenimin e parimeve procedurale kushtetuese të ankimit dhe të aksesit në gjykatë.

Këto parime nuk mund të cenohen sepse janë elemente të së drejtës në tërësi, që rrjedhin nga thelbi i shtetit të së drejtës dhe garantojnë barazinë e palëve në një proces gjyqësor. Prandaj dhe ankimi në Gjykatën Kushtetuese për shkëlqen e tyre mund të paraqitet nga çdo subjekt, duke përfshirë këtu edhe personat juridikë publikë.

Këtë qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese Gjermane, në çështje të ngjashme. Në vendimin e datës 02.05.1967, lidhur me të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe të drejtën për një proces të rregullt ligjor shprehet: "... këto dispozita procedurale nuk bëjnë pjesë në përmbajtjen e nenit 19 të Kushtetutës (e njëjtë me përmbajtjen e neneve 16 e 17 të Kushtetutës shqiptare – sh.im) ato nuk përmbajnë të drejta individuale, por parime të së drejtës procedurale, të cilat duhet të respektohen në çdo proces dhe të shfrytëzohen nga çdo subjekt që në bazë të normave procedurale mund të konsiderohet palë në proces ose preket në mënyrë të drejtpërdrejtë nga procesi. Në një proces gjyqësor çdo subjekt pjesëmarrës në të i nënshtrohet njëlloj juridiksionit vendimmarrës të gjykatës. Të drejtat procedurale duhet t'i vihen në dispozicion pjesëmarrësve në proces duke respektuar parimin e barazisë së armëve".²

Lidhur me pretendimet e palës kërkuese, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Gjykata Kushtetuese konstaton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke pushuar çështjen me arsyetimin se mungon ankimi, i ka cenuar atij të drejtën e ankimit dhe të drejtën për pranim të shqyrtimit të çështjes në atë gjykatë (e drejta e aksesit në gjykatë).

Rezultoni se kërkuesi ka bërë rekurs kundër vendimit nr.9, datë 28.01.2004 të Gjykatës së Apelit Vlorë, me të cilin janë konstatuar si të pavlefshëm titujt ekzekutivë për borxhin doganor të subjektit të interesuar. Rekursi i paraqitur në gjykatë mban datën e përpilimit 27.02.2005, ndërsa administrata gjyqësore, ndonëse e ka marrë rekursin, ka shënuar si datë pranimit datën 28.02.2005, që është ditë e shtunë, pra, ditë pushimi që zyrtarisht nuk funksionojnë institucionet.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke pranuar si ditë paraqitjeje datën 28.02.2005, e konsideron jashtë afatit dorëzimin e rekursit në gjykatë.

Lidhur me këtë qëndrim, Gjykata Kushtetuese konstaton se e drejta e ankimit, ashtu si edhe ajo e aksesit në gjykatë nuk mund t'i cenohen kërkuesit për shkaqe që rrjedhin nga mangësitë apo gabimet në veprimtarinë e vetë organeve shtetërore. Kështu konkretisht vetë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, megjithëse ka pranuar se rekursi është paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në ditë pushimi, se ai mban siglën e punonjësit të gjykatës të ngarkuar me pranimin e rekurseve dhe se administrata gjyqësore nuk e ka evidentuar këtë dorëzim rekursi në regjistrat e veta, në vend që të pranonte shqyrtimin e rekursit në seancë gjyqësore, e refuzon atë duke i mohuar kërkuesit të drejtën e ankimit dhe atë të aksesit në Gjykatën e Lartë.

Duke u nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se rekursi duhet konsideruar se është paraqitur në afat dhe si rrjedhojë duhet pranuar për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.736, datë 28.04.2005 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë;
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

² Vendim i Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane Bverf GE 21, 362 (373)

MENDIMI I PAKICËS

Kemi mendimin se kërkesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, dega Vlorë, duhej të rrëzohej për këto shkaqe:

1. Nga provat që ndodhen në dosje, rezulton se rekursi i paraqitur nga kërkuesi mban siglën e punonjësit të gjykatës të ngarkuar me këtë detyrë datë 28.02.2004, kur afati i fundit për dorëzimin e tij ishte data 27.02.2004.

Siç del edhe nga arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë, kërkuesit iu la detyrë nga kjo Gjykatë që të vërtetojë pretendimin se e ka paraqitur rekursin brenda afatit ligjor, por ai nuk e ka bërë një gjë të tillë. Në këto rrethana, Gjykata e Lartë, duke iu referuar nenit 476 të Kodit të Procedurës Civile, me të drejtë ka konkluduar se rekursi është paraqitur jashtë afatit e për rrjedhojë e ka konsideruar se ai mungon.

Duke qenë çështja si më sipër, kur Gjykata e Lartë ka bërë vlerësim të provave dhe ka arritur në një përfundim të caktuar, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese që me një vlerësim tjetër të arrijë në përfundim të kundërt.

Veç kësaj, mënyra se si shumica arsyeton vendimin e saj, nuk qëndron, pasi nga materialet e çështjes konkrete nuk rezulton që Gjykata e Lartë të jetë mbështetur në prova të dyshimta pasi rekursi i dorëzuar me shënimin përkatës jo vetëm që nuk është goditur për falsitet, por nuk ka asnjë të dhënë për të dyshuar për rregullsinë e tij.

Anëtarë: K.Peçi, F.Abdiu, D.Karamuço

KËRKESË

Shtetësja Lumnije Bishja, banuese në Shkodër, kërkon deklarinimin e vdekjes së shtetasit Dashamir Muçllari.

**KËRKUESE
Lumnije Bishja**

KËRKESË PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurisë së paluajtshme, pronë private, të tipit “Tokë bujqësore arë”, që preket nga “Ndërtimi i nënstacionit 110/ 20 kv Elbasan”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: “KESH” sh.a., TIRANË.

Me anën e këtij publikimi në shtyp, kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë së paluajtshme që shpronësohet dhe masën përkatëse të kompensimit, të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për të gjithë bashkëpronarët, sipas listës emërore të mëposhtme.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS

LISTA E BASHKËPRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË “NËNSTACIONIT 110/20 kV ELBASAN”

RRETHI: Elbasan
BASHKIA: Elbasan
Lagja: 28 Nëntori

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: Tokë bujqësore arë
Lloji i pasurisë që dëmtohet për shkak të ndërtimit nënstacionit: Kulturë bujqësore (misër).

Nr.	Shpronësimi i pasurisë së paluajtshme “Toke arë”										Vlera totale e kompensimit në lekë	Adresa e pronarëve			
	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Sasia në m ²	Kategoria e tokës	Çmimi në lek/m ²	Vlera e kompensimit në lekë			Sasia në ha	Lloji kult. bujqësore të dëmtuar	Vlera në leke për kompensim
1	Violeta		Ajazi	Tokë arë	8526	88/1	4279	II	1500	6.418.500	0.4 ha	misër	112.000	6.530.500	Lagjia: Emin Matraxhiu, Elbasan
2	Afrida	Ymer	Balashi												
3	Devis	Agron	Balashi												
4	Greta	Agron	Balashi (Hakami)												
5	Suljon	Agron	Balashi												
6	Bashkim		Arapi												
7	Liri		Arapi												
8	Pellumb		Arapi												
9	Shpresa		Arapi												
10	Diana		Arapi												
11	Naim		Peqini												
12	Fatbardha		Peqini												
13	Arben		Peqini												
14	Dashamir		Peqini												
15	Klajdi		Arapi												
16	Irida		Arapi												

VO: Të gjithë personat, pasuria e të cilëve shpronësohet, sipas certifikatës së vërtetimit të pronësisë, janë bashkëpronarë në këtë pasuri.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot", Tel: 042 555 63; ose 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
 - 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
 - 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
 - 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**
-
- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006) | 1500 |
| 2. | PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) | 600 |
| 3. | PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).... | 1500 |
| 4. | PËR TAKSAT DHE TATIMET (+suplement 2006) | 1500 |
-
- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT..... | 1500 |
| 2. | TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT..... | 2000 |

BOTIME TË REJA

- | | | |
|-----------|---|-------------|
| 1. | PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT | 500 |
| 2. | KODI DOGANOR | 1000 |
| 3. | KODI DETAR | 1000 |

Hyri në shtyp më 2.8.2006
 Doli nga shtypi më 4.8.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Ilar"
 Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë